

FJALOR UDHËZUES

Për Njohjen e Programeve
të Komunitetit Europian:

**FP7, COST, EUREKA,
MARIE CURIE**

akti

AGJENCIA E KËRKIMIT
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

FJALOR UDHËZUES

Për Njohjen e Programeve të Komunitetit European:
FP7, COST, EUREKA, MARIE CURIE



PËRMBAJTJA E LËNDËS

AKTI	<i>faqe 7</i>
Programe Kuadër për Kërkim dhe Zhvillim	<i>faqe 9</i>
Programe të tjera për Kërkim dhe Zhvillim (R&D)	<i>faqe 17</i>
Rrjete Kërkimore - Shkencore	<i>faqe 25</i>
Terma Teknik FP7	<i>faqe 27</i>
“Pas FP7-ta”	<i>faqe 33</i>
Terminologji	<i>faqe 35</i>
Modeli i Marrëveshjes së Grantit	<i>faqe 37</i>
Modeli i Marrëveshjes së Konsortiumit	<i>faqe 41</i>
Guida Praktike - COST, EUREKA, MARIE CURIE	<i>faqe 53</i>



“DY FJALË KOLEGËVE NË VEND TË HYRJES”

Të nderuar studiues, pedagogë dhe pjesëtarë të komunitetit shkencor. Si koleg dhe pjesëtar i këtij komuniteti për më tepër se tre dekada, kam dëshirën dhe kënaqësinë t’ju drejtohem me dy fjalë.

Siç e dini, shkenca, teknologjia dhe inovacioni vlerësohen si faktorë themelorë për një ekonomi të orientuar nga dijet dhe janë të rëndësishme në të gjitha fazat e zhvillimit, pavarësisht nga format dhe mënyrat e ndryshme të tyre.

Bashkimi Europian (BE), ku aspiron të futet Shqipëria, ka përcaktuar objektiva të qarta që lidhen me kërkimin dhe inovacionin si pjesë e “Strategjisë së Lisbonës për ta bërë BE-në ekonominë më kompetitive në botë”. Shqipëria, si dhe vende të tjera kandidatë dhe të asociuara të Ballkanit Perëndimor po ndërmarrin hapat e nevojshëm për ta çuar kërkimin në nivele Europiane.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015 si edhe krijimi në bazë të saj i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit në muajin Gusht të vitit 2009, përbëjnë hedhjen e disa prej këtyre hapave drejt arritjes së standardeve bashkëkohore Europiane.

Në këtë kuadër Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke marrë parasysh kompleksitetin e Programeve dhe Rrjeteve Kërkimore Shkencore të Komunitetit Europian është përpjekur të përmbledh në një punim të vetëm koncepte bazë të kësaj fushe.

Botimi i këtij « Fjalori-Udhëzues » ju drejtohet juve Komunitetit Kërkimor - Shkencor, përfshirë këtu Kërkuesit Individualë, Grupet Kërkimore-Shkencore, Universitetet Publike dhe Private, Institutet dhe Institucionet Kërkimore Shkencore, me veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi primar i « Fjalorit-Udhëzues » është informimi juaj si komunitet, mbi Programet dhe Rrjetet Kërkimore Shkencore të Komunitetit Europian.

Për më tepër ky « Fjalor-Udhëzues » i vjen në ndihmë komunitetit kërkimor shkencor me informacion praktik mbi mënyrën e pjesëmarrjes në këto programe të cilat koordinohen nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Duke shpresuar që me këtë material t'ju bëhemi sadopak të vlefshëm, ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj kërkimore shkencore.

Me respekt,
Prof. Dr. YLLI PANGO

*Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit*

AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)

Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) është krijuar me VKM nr. 903 Dt. 26.08.2009 “Për Krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit” si një institucion juridik publik, në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Misioni i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit është të vlerësojë, të financojë, të monitorojë dhe të administrojë programet dhe projektet në fushën e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Shqipëri.

Gjithashtu, AKTI ka si qëllim financimin e projekteve në fushën e biznesit të vogël dhe të mesëm si dhe transferimin, modernizimin dhe rinovimin e teknologjive të tyre.

Agjencia funksionon si një strukturë koordinuese për programe dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, bazuar në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe vendeve të ndryshme.

Organet e drejtimit të AKTI-it janë:

- a) Bordi Drejtues
- b) Drejtori i Përgjithshëm

Bordi drejtues është organi kolegjal vendimmarrës i AKTI-it, që kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.



PROGRAME KUADËR PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

FP- (*Framework Programme*) Programet kuadër janë linçuar nga Bashkimi Europian me qëllim zhvillimin dhe promovimin e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Programet Kuadër kanë filluar më datë 1984 me Programin e Parë Kuadër. Aktualisht është duke operuar Programi i Shtatë Kuadër, 2007- 2013.

- **(1984-1987):** Programi i Parë Kuadër;
- **(1987-1991):** Programi i Dytë Kuadër;
- **(1990-1994):** Programi i Tretë Kuadër;
- **(1994-1998):** Programi i Katërt Kuadër;
- **(1998-2002):** Programi i Pestë Kuadër;
- **(2002-2006):** Programi i Gjashtë Kuadër;
- **(2007-2013):** Programi i Shtatë Kuadër.

FP7 - (*7th Framework Programme of the European Community for Research, Technological Development and Demonstration Activities*)

Në datën 1 Janar 2008, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, është nënshkruar “Memorandumi i Mirëkuptimit mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian mbi Kërkimin, Zhvillimin Teknologjik dhe Aktiviteteve të Demonstrimit FP7 (2007-2013)”. Bazuar në “Memorandumin e Mirëkuptimit”, Shqipërisë i është akorduar statusi “Vend i Asociuar” duke i dhënë mundësinë të marrë pjesë në të gjitha Thirrjet për Aplikime dhe të konkurrojë në nivel të barabartë me vendet anëtare të Bashkimit Europian, për bashkëpunimin në kërkimin shkencor dhe mbështetjen e aktiviteteve në kuadrin e [FP7](#).

FP7 ka një buxhet prej 50 miliardë Euro, në një periudhë kohore prej 7 vitesh (2007-2013) dhe jep mundësinë për financimin e kërkimit në fusha strategjike të grupuara në kategori:

- Bashkëpunimi
- Idetë
- Njerëzit
- Kapacitetet
- Euroatomi
- JRC- Joint Research Centre (Qendra të Përbashkëta Kërkimi)

Programet Specifike të FP7 janë si më poshtë:

COOPERATION	Health	IDEAS	European Research Council
	Food, agriculture and biotechnology		Initial training
	Information and communication technologies	PEOPLE	Life-long training
	Nanosciences, nanotechnologies, materials and new production technologies		Industry-academia
	Energy		International dimension
	Environment (including climate change)	CAPACITIES	Specific actions
	Transport (including aeronautics)		Research infrastructures
	Socio-economic sciences and the humanities		Research for the benefit of SMEs
	Security and Space		Regions of Knowledge
			Research potential
	Science in society	Coherent development of research policies	
		International co-operation	
		Non-nuclear actions by the Joint Research Centre	
		Euratom for actions by the Joint Research Centre	

COOPERATION - (*Bashkëpunimi*) Në këtë shtyllë financohen projekte që synojnë të rrisin bashkëpunimin midis aktorëve të kërkimit shkencor. Projekte me qëllim kërkimor - shkencor.

IDEAS - (*Idetë*) Në këtë shtyllë financohen projekte që synojnë idetë më inovative dhe të spikatura të kërkimit shkencor.

CAPACITIES - (*Kapacitetet*) Kapacitetet financojnë ngritjen dhe rritjen e kapaciteteve për kërkimin shkencor p.sh: krijimin e rrjeteve, mbajtjen e konferencave etj.

PEOPLE - (*Njerëzit*) Kjo shtyllë financohet projekte që synojnë ngritjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore duke përdorur skemat “Marie Curie”.

Aksionet “Marie Curie” synojnë shkëmbimin e eksperiencave, rritjen profesionale dhe zhvillimin e kërkimit shkencor, nëpërmjet lëvizjes së kërkuesve nga një vend në një vend tjetër.

JRC - (Joint Research Centres) Qendra të Përbashkëta Kërkimi

Në vitin 1957 u sanksionuan dy Traktate:

1. Ngritja e Komunitetit Ekonomik Europian
(*European Economic Community EEC*)
2. Ngritja e Komunitetit Europian të Energjisë Atomike
(*European Atomic Energy Community EURATOM*)

Qendra e Përbashkët e Kërkimit është krijuar nën Traktatin e EURATOM-it. Roli i Traktatit të EURATOM-it është të promovojë mbrojtjen bërthamore dhe sigurinë në Europë. JRC ka ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi me aktivitetet e saj që prej kohës së krijimit.

Janë ngritur 7 Qendra të Përbashkëta Kërkimi, misioni i të cilave është të sigurojnë mbështetje shkencore dhe teknike për konceptimin, zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e politikave Europiane.

7 JRC –të janë:

- **IRMM**- Instituti për Materiale dhe Matje Referuese – Bruksel, Belgjikë
(*The Institute for Reference Materials and Measurements*)
- **ITU**- Instituti për Elementët Transuraniu- Karlsruhe, Gjermani
(*The Institute for Transuranium Elements*)
- **IET**- Instituti për Energji dhe Transport – Petten, Hollandë
(*The Institute for Energy and Transport*)
- **IPSC**- Instituti për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Qytetarëve- Ispra, Itali
(*The Institute for the Protection and Security of the Citizen*)
- **IES**- Instituti për Mjedisin dhe Qëndrueshmërinë- Ispra, Itali
(*The Institute for Environment and Sustainability*)
- **IHCP**- Instituti për Shëndetin dhe Mbrojtjen e Konsumatorit- Ispra, Itali
(*The Institute for Health and Consumer Protection*)
- **IPTS**- Instituti për Studime Prospektive Teknologjike- Ispra, Itali
(*The Institute for Prospective Technological Studies*)

JOINT TECHNOLOGY INITIATIVES (JTI) - (Joint Technology Initiatives)

Iniciativat e Përbashkëta Teknologjike janë një mjet për të zbatuar Agjendën Strategjike të Kërkimit dhe Platformat Teknologjike Europiane. Zbatimi efektiv

i këtyre platformave kërkon një mekanizëm të përkushtuar që mundëson udhëheqjen e nevojshme dhe koordinim të efektshëm. Ky synim arrihet nëpërmjet Iniciativave të Përbashkëta Teknologjike.

JTI janë entitete ligjore të pavarura që menaxhojnë projekte kërkimore në një mënyrë të integruar. JTI-të kanë një buxhet dhe personel të caktuar.

RTD - (*Research, Technological development and Demonstration activities in the European Union*) Aktivitetet e Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Demonstrimit në Komunitetin Europian.

ERA - (*European Research Area*) e krijuar në vitin 2000, Zona Europiane e Kërkimit përbëhet nga të gjitha aktivitetet e zhvillimit dhe kërkimit, programet dhe politikat në Europë të cilat përfshijnë një perspektivë transnacionale. Së bashku ato mundësojnë, kërkuesit, institucionet kërkimore dhe bizneset të qarkullojnë, konkurrojnë dhe bashkëpunojnë përtej kufijve.

ERA GOVERNANCE STRUCTURES- Strukturat e qeverisjes së Zonës Europiane të Kërkimit kanë qëllim zhvillimin e ERA-s për të kapërcyer fragmentarizmin e kërkimit në Europë, së bashku me barrierat kombëtare dhe institucionale.

ERAC- (*European Research Area Committee*) Komiteti Europian i Zonës së Kërkimit.

ERAC- Komiteti Europian i Zonës së Kërkimit, është një organ këshillimor i strategjive politike, funksioni i të cilit është të ndihmojë Komisionin Europian dhe Këshillin e Bashkimit Europian në kryerjen e detyrave të tyre në fushën e Kërkimit dhe Zhvillimit Teknologjik.

Aktivitetet ERAC kanë fituar më shumë rëndësi për shkak të famës më të madhe të Kërkimit dhe Zhvillimit Teknologjik në Europë, e cila është njohur në ditët e sotme si një element i rëndësishëm i aftësisë konkurruese të Europës dhe të rritjes ekonomike.

Shqipëria ka statusin e 'vëzhguesit' në këtë komitet.

SCAR- (*Standing Committee on Agricultural Research*)

Komiteti i Përhershëm për Kërkimin në Bujqësi

SCAR- këshillon Komisionin e BE-së në fushën e koordinimit të kërkimit shkencor në bujqësi.

Këtu përfshihen:

- Diskutime strategjike afatgjata në fushën e kërkimit shkencor në bujqësi në Europë (FP7 dhe më gjerë);
- Rritjen e bashkëpunimit midis shteteve anëtare në këtë fushë;
- Shkëmbim informacioni me mekanizmat plotësuese sipas programeve kuadër të BE.

SCAR përbëhet nga përfaqësues të shteteve anëtare të SCAR dhe kryesohet nga një përfaqësues i Komisionit European. SCAR ka vendosur që përfaqësuesit nga vendet Kandidate, (Kroacia, Maqedonia, Turqia) dhe vendet e Asociuara (Shqipëri, Islandë, Izrael, Mal i Zi, Norvegji, Serbi, Zvicër), do të marrin pjesë si ‘vëzhgues’ në takimet SCAR dhe do të përfshihen plotësisht në punën e saj.

ESFRI- (*European Strategy Forum for Research Infrastructure*)

Forumi Strategjik European për Infrastrukturën e Kërkimit

ESFRI- është një instrument strategjik për zhvillimin dhe integrimin shkencor të Europës dhe forcimin e pozitës së saj në arenën ndërkombëtare.

Misioni i ESFRI është të mbështesë në mënyrë koherente dhe strategjike krijimin e politikave për infrastrukturën kërkimore në Europë, dhe të lehtësojë iniciativat shumëpalëshe që çojnë në përdorim dhe zhvillim më të mirë të infrastrukturave kërkimore, në BE dhe në nivel ndërkombëtar.

ESFRI - përbëhet nga delegatë të emëruar nga Ministrat e Kërkimit të vendeve Anëtare dhe të Asociuara si edhe nga përfaqësuesit e Komisionit, të cilët bashkëpunojnë së bashku për të zhvilluar një vizion dhe një strategji të përbashkët.

Përbërja e ESFRI :

- Anëtarët e ESFRI
- Kryetari
- Bordi Ekzekutiv
- Sekretariati Ekzekutiv

SGHRM- (*Steering Group on Human Recourses and Mobility*)

Grupi Drejtues për Burime Njerëzore dhe Mobilitete

SGHRM- ky grup është aktivizuar nga Komisioni European në vitin 2002 për të qenë forumi më i përshtatshëm për zhvillimin e partneritetit të kërkuesve Europeanë në një mënyrë fleksibile. Ky grup do të jetë struktura kryesore për të nxitur, monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e partneritetit të kërkuesve.

Projekt mandati i këtij grupi përfshin:

- Forcimin e aktiviteteve të mësimit të ndërsjellët, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, identifikimin e praktikave më të mira dhe, kur është e përshtatshme, përdorimin e shpjegimeve midis kolegëve.
- Përcaktimin dhe përdorimin e treguesve të përshtatshëm për monitorimin e progresit, në nivel kombëtar si dhe të komunitetit.
- Zhvillimin e udhëzimeve të përbashkëta ku ata mund të përforcojnë zbatimin e vazhdueshëm të veprimeve me interes të përbashkët, apo të ndërmarrin veprime të reja e të përmirësuara.
- Kontribuimin në përcaktimin e veprimeve komunitar.
- Kontaktimin me grupet e tjera relevante dhe palët e interesuara për të arritur realizimin më të mirë të iniciativave ekzistuese.

SFIC- (*Strategic Forum for International S & T Cooperation*)

Forumi Strategjik për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Shkencor dhe Teknologjik.

Objektivi i tij është të lehtësojë zhvillimin e mëtejshëm, zbatimin dhe monitorimin e dimensionit ndërkombëtar të Kërkimit European. Në praktikë, kjo do të thotë ndarjen e informacionit dhe konsultimit midis partnerëve (shteteve Anëtare dhe Komisionit European), me qëllim identifikimin e prioritetëve të përbashkëta të cilat mund të çojnë në iniciativa të koordinuara.

SFIC përbëhet nga përfaqësues të niveleve të larta të shteteve Anëtare dhe Komisionit European. Drejtimi në SFIC është caktuar nga radhët e përfaqësuesve të vendeve anëtare për një periudhë prej dy vjetësh.

GPC- (*High Level Group for Joint Programming*)

Grupi i Nivelit të Lartë për Programim të Përbashkët

GPC- është përgjegjës për identifikimin e temave për programim të përbashkët dhe do të kontribuojë në përgatitjen e vendimeve të Këshillit në këtë fushë.

Anëtarët GPC-së janë zyrtarë të lartë nga vendet anëtare dhe Komisionit European. Vendet pjesëmarrëse në Programet Kuadër mund të marrin pjesë në grup.

ERIC- (*European Research Infrastructure Consortium*)

“Konsortiumi European mbi Infrastrukturën e Kërkimit” është krijuar me Vendim të Këshillit European, i cili ka hyrë në fuqi më 28 Gusht 2009.

“Konsortiumi European mbi Infrastrukturën e Kërkimit” ka për synim organizimin e shteteve dhe institucioneve përkatëse për të ndërmarrë kërkim shkencor në një fushë të caktuar, duke vënë në përdorim burimet e tyre infrastrukturore për një periudhë kohore që varion deri në disa vjet.

Shtetet dhe organizatat ndërqeveritare mund të aplikojnë për të ngritur një ERIC. Një ERIC duhet të përfshijë të paktën tri vende anëtare të BE, si anëtarë të tij. Vendndodhja duhet të jetë në një shtet anëtar të BE, ose në një shtet të asociuar.

Një ERIC do të ketë personalitet juridik, që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për ngritjen e ERIC. ERIC do të ketë në çdo shtet anëtar kapacitetin e nevojshëm ligjor, në lidhje me personat juridik, në bazë të ligjit të atij shteti anëtar. ERIC mund, në veçanti, të fitojë, disponojë pasuri të luajtshme, e të paluajtshme dhe pasuri intelektuale, duke përfshirë lidhjen e kontratave dhe pjesëmarrjen si palë, në një procedurë ligjore. Një ERIC është një organizatë ndërkombëtare në kuptim të pikës (c) të Nenit 15 të Direktivës 2004/18/EC.



PROGRAME TË TJERA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (R&D)

EURAXESS- është një iniciativë e përbashkët e Komisionit Europian dhe vendeve pjesëmarrëse në Programet Kuadër të Kërkimit Shkencor.

EURAXESS është një network, i krijuar për t'i ardhur në ndihmë të gjithë kërkuesve të cilët dëshirojnë të çojnë përpara karrierën e tyre dhe zhvillimin personal duke lëvizur nga një vend në tjetrin.

Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është të sigurojë asistencë të personalizuar për studiuesit dhe kërkuesit shkencorë në lëvizje, në çdo aspekt të jetës së tyre (çështjet e vizave, leje pune, strehim, çështjet e sigurimit shëndetësor, taksave, sigurimeve shoqërore etj) si dhe për të promovuar strategjinë e burimeve njerëzore si p.sh. Karta Europiane për Kërkuesit dhe Kodi i Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve. Gjithashtu, EURAXESS ofron informacion mbi bashkëpunimet ndërkombëtare për kërkim shkencor dhe politikat Europiane të kërkimit dhe zhvillimit.

Websit-i i EURAXESS përbëhet nga 4 (katër) seksione kryesore:

EURAXESS Jobs- Në këtë seksion kërkuesit mund të gjejnë informacion të bollshëm e të përditësuar vazhdimisht, në lidhje me vendet e lira të punës, mundësi financimi dhe bursa në të gjithë Europën. Nëpërmjet postimit të CV-ve të çdo kërkuesi do të jetë më e lehtë të kontaktohen nga institucionet e vendeve vakante.

Kompanitë dhe institucionet kërkimore mund të shpallin pa pagesë vendet e tyre vakante.

EURAXESS Services- është një network me më shumë se 200 (dy qind) qendra shërbimi të vendosura në 37 vende Europiane. Këto qendra ndihmojnë kërkuesit dhe familjet e tyre të planifikojnë dhe organizojnë lëvizjen e tyre në një vend të huaj. Ndihma konsiston në akomodim, lejet e qëndrimit-vizat, mësimin e gjuhës, shkollim për fëmijët, sigurimet shoqërore, kujdesi shëndetësor.

EURAXESS Rights- siguron të gjithë informacionin bazë, në lidhje me Kartën Europiane për Kërkuesit dhe Kodin e Sjelljes për rekrutimin e Kërkuesve. Karta Europiane vendos të drejtat dhe detyrat e kërkuesve, kërkimet dhe financimin e tyre. Kodi synon të sigurojë trajtimin e barabartë të gjithë kërkuesve në Europë dhe rrit transparencën për rekrutimin e tyre.

EURAXESS Links - është një rrjet për studiuesit europianë që punojnë jashtë Europës. Këtu ata mund të gjejnë informacion të gjerë për kërkimin shkencor në Europë, politikat europiane kërkimore, mundësitë për karrierë në Europë, mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar.

COST (*European Cooperation in Science and Technology*)

Programi i Bashkëpunimit European në Shkencë dhe Teknologji.

COST është një kornizë ndërqeveritare për bashkëpunimin European, në fushën e shkencës dhe të teknologjisë.

COST synon të sigurojë që Europa të ketë një pozitë të fortë në fushën e kërkimit shkencor dhe teknologjik, duke rritur bashkëpunimin European dhe ndërveprimin në këtë fushë. Kjo nismë bën të mundur, për subjekte të ndryshme kombëtare, si p.sh institute, universitete, dhe industri private, për të punuar së bashku në një gamë të gjerë të aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit.

COST ka treguar shumë qartë forcën e saj në zgjidhjen e problemeve mjedisore, ndër-kufitare dhe problemeve të shërbimit publik. COST është përdorur me sukses si një instrument i rëndësishëm për të maksimizuar bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor dhe, në të njëjtën kohë, është një mjet i dobishëm për integrimin e mëtejshëm europian.

COST luan një rol parësor në ndërtimin e Fushës së Kërkimit European, European Research Area (ERA). Ky program parashikon dhe plotëson veprimtarinë e programeve kuadër të BE duke formuar kështu një urë lidhëse për komunitetet shkencore të vendeve në zhvillim. COST gjithashtu rrit lëvizjen e studiuesve në hapësirën europiane dhe nxit krijimin e përsosmërisë shkencore në 9 (nëntë) fushat kryesore:

- Bio-mjekësi dhe Bio-shkenca Molekulare;
- Ushqim dhe Bujqësi;
- Pyjet, Produktet dhe Shërbimet e tyre;
- Materiale, Fizikë, dhe Nanoshkenca;
- Kimi dhe Shkenca e Teknologji Molekulare;
- Shkenca të Sistemit Tokësor dhe Menaxhimit të Mjedisit;
- Teknologjitë e Komunikimit dhe Informacionit;
- Zhvillimi i Transportit (përfshirë edhe atë urban);
- Individë, Shoqëri, Kultura dhe Shëndeti.

Ekzistojnë disa informacione, modalitete dhe rregulla kontraktuese të dobishme për të gjithë shkencëtarët dhe institucionet, të cilët dëshirojnë të punojnë me COST. Ka kushte dhe hapa të ndryshme, të cilat duhen ndjekur në mënyrë të tillë, që të marrësh pjesë në COST, apo të fillojë veprimi i tij.

Shqipëria listohet në një nga vendet jo pjesëmarrëse në COST, në ndryshim nga 36 vendet pjesëmarrëse të saj. Për këto vende jo pjesëmarrëse parashtrihen rregulla të tjera përfitimi nga programi COST.

Përveç vendeve anëtare COST, shteteve bashkëpunuese, Komisionit dhe subjekteve europiane, Komiteti i Zyrtarëve të Lartë, CSO (Committee of Senior Officials) mund të pranojë organizata të tjera ndërkombëtare, apo institucione kërkimi, të cilat bëjnë pjesë në vendet jashtë strukturës së COST, si pjesëmarrës në veprime specifike të COST, në përputhje me dispozitat e paracaktuara. Këto institute referohen si “Non-COST Institutions”

Një kërkesë aplikimi nga një “ Non-COST Institution” drejtuar kryetarit të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë do të trajtohet nga ana e këtij komiteti mbi bazën e një rasti të arsyeshëm në kontributin e pritur nga ai institucion aplikues, për të arritur objektivat e aksionit për të cilin aplikohet. Aplikimi paraqitet tek Komiteti i Zyrtarëve të Lartë nga Komiteti i Menaxhimit, në bashkëpunim me Komitetin e Fushave.

Kriteri kryesor për pranimin e një institucioni “non COST”, si një pjesëmarrës në veprim, është përfitimi reciprok. Megjithatë, Komiteti i Zyrtarëve të Lartë, merr parasysh kritere politike si dhe kritere të tjera të ndryshme.

Kur lejohet që një institucion “non COST” të marrë pjesë në veprimet e programit COST, Komiteti i Zyrtarëve të Lartë ka të drejtë të bashkëngjisë kushte të veçanta për këtë pjesëmarrje. Të drejtat dhe detyrimet e institucionit rregullohen nëpërmjet shkëmbimit të letrave midis institucionit dhe Presidentit të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë.

Një institucion “non COST” merr pjesë në veprim në të njëjtën pozitë, ashtu si palët e Memorandumit të Mirëkuptimit, përveç faktit që nuk ka të drejtën e votës në Komitetin e Menaxhimit apo Grupet e Punës.

Kur më shumë se dy institucione nga i njëjti vend “non COST” marrin pjesë në të njëjtin aksion, atyre u kërkohet të koordinohen midis tyre dhe në të njëjtën kohë në mbledhjen e Komitetit Menaxhues u lejohet të përfaqësohen me deri në dy përfaqësues, nga secili institucion i vendit specifik “non COST”.

Non Cost Country janë vendet jo anëtare të COST të cilat marrin pjesë në COST, me këtë lloj Statusi, i cili mbart të drejta dhe detyrime të ndryshme nga ato të një vendi anëtar të COST.

EUREKA- EUREKA është një rrjet ndërqeveritar i themeluar nga Konferenca e Ministrave të Jashtëm të 17 vendeve Europiane dhe përfaqësuesve të Komisionit European, në një takim të mbajtur në Paris më 17 korrik 1985.

Që nga krijimi i Programit “EUREKA”, fondet e konsiderueshme publike dhe private kanë qenë të konceptuara për të mbështetur orientimin e tregut drejt kërkimit dhe zhvillimit, projektet inovative në fushën e industrisë, orientimin e qendrave kërkimore dhe universiteteve, drejt sektorëve teknologjikë.

Aktualisht “EUREKA” numëron 39 anëtarë, duke përfshirë Bashkimin European, ndërkohë që shumë vende të tjera, jo anëtare, marrin pjesë në “EUREKA”, përmes një rrjeti të Pikave Kombëtare të Informacionit (NIP), siç është edhe rasti i Shqipërisë.

“EUREKA” ndihmon në :

- Gjetjen e partnerëve potencial për projekt-idenë tuaj;
- Gjetjen e tregut për produktin, procesin apo shërbimin tuaj;
- Dhënien e një emërtimi të njohur ndërkombëtarisht nga “EUREKA”.

“EUREKA” nuk financon projekte. Nga nën - programet e saj (CLUSTERS, UMBRELLAS), vetëm “EUROSTARS” mbështet në përqindje të caktuar projektin tuaj, duke u bazuar në parimin e bashkëfinancimit.

“EUREKA” mbështet këto “Nën-Programet”:

- **“CLUSTER”**, është një nën-program i rëndësishëm industrial, afatgjatë dhe strategjik.
Projektet “Clusters” kanë për qëllim të zhvillojnë teknologji të reja me rëndësi kyçe për konkurrencën Europiane, kryesisht në ICT, energji dhe, kohët e fundit, një zhvillim të rëndësishëm ka marrë sektori i Bioteknologjisë. Këto projekte karakterizohen nga një numër i madh i pjesëmarrësish. “CLUSTERS” sjell së bashku kompani të mëdha, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, institute kërkimore dhe universitete me fokus zhvillimin dhe shfrytëzimin komercial të teknologjive të reja. Qëllimi kryesor është që Europa të mbajë pozicionin lider në tregun botëror.
- **“PROJEKTE INDIVIDUALE”**, mbështetja e projekteve individuale të Kërkimit dhe Zhvillimit paraqet veprimtarinë kryesore të rrjetit “EUREKA”.
“Projektet individuale”, janë projekte të vogla dhe me një kohëzgjatje të shkurtër, përfshijnë pjesëmarrës nga të paktën dy vende anëtare të EUREKA-s, rezultati duhet të jetë një produkt, proces apo shërbim që sjell një zhvillim të rëndësishëm në sektorin përkatës.
- **“EUROSTARS”**, është një nën program bashkëfinancues, i cili i është dedikuar në mënyrë specifike veprimtarisë kërkimore të SME-ve (*Ndërmarrjeve të vogla e të mesme*).
“Eurostar” është një nën-program Europian për kërkim dhe zhvillim, i cili mund t’i drejtohet çdo fushe teknologjike, por duke patur një synim civil dhe për qëllim zhvillimin e një produkti, procesi apo shërbimi.
“Projektet Eurostars” janë projekte bashkëpunimi, duke përfshirë së paku dy pjesëmarrës (persona juridik) nga dy vende të ndryshme, anëtare të projektit “Eurostar”. Përveç kësaj pjesëmarrësi kryesor duhet të jetë një SME, e regjistruar në një vend anëtar e cila ka në statusin e saj veprimtari kërkimore.

Roli i kësaj SME-je në projekt duhet të jetë i rëndësishëm dhe rreth 50% e aktiviteteve kryesore në kuadër të projektit duhet të kryhen nga kjo SME. Konsortiumi duhet të jetë i mirë balancuar, kjo nënkupton se asnjë pjesëmarrësi, apo vendi nuk do t'i kërkohej të investojë më shumë se 75% të kostos totale të Projektit.

Një projekt “EUROSTARS” duhet të ketë së paku tri vjet jetëgjatësi dhe, me përfundimin e projektit, produkti duhet të jetë gati për treg. Përfundimi nga ky rregull bëjnë projektet biologjike, apo mjekësore, ku provat klinike duhet të vazhdojnë edhe dy vjet pas përfundimit të projektit.

- “**UMBRELLAS**”, janë rrjete (networks) tematik, brenda kuadrit të “**EUREKA**” që përqendrohen në një fushë specifike të teknologjisë, ose të biznesit. Aktivitetet “**UMBRELLAS**” janë të koordinuara dhe zbatohen nga një grup pune, i përbërë nga përfaqësues të “**EUREKA**” dhe ekspertë industriale. Qëllimi kryesor i këtyre rrjeteve është të lehtësojë krijimin e Projekteve “**EUREKA**” në fushat e synuara nga “**EUREKA**”.

WBC-INCO.NET (Coordination of Research Policies with the Western Balkan Countries). Koordinimi i Politikave të Kërkimit me Vendet e Ballkanit Perëndimor.

“**WBC-INCO.NET**” është krijuar si një projekt i madh strategjik, për të mbështetur bashkëpunimin në fushën e Shkencës dhe Teknologjisë, midis Bashkimit Europian, vendeve të asociuara në FP7 dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor.

3 Objektivat kryesore të **WBC-INCO.NET** janë:

- Mbështetja e dialogut ndër-rajonal në shkencë dhe teknologji, duke bashkëvepruar në një ndarje efektive të punës me Platformën Drejtuese në Kërkim.
- Identifikimi i prioriteteve dhe potencialit në Kërkim, Teknologji dhe Zhvillim (RTD) në një mënyrë sa më transparente dhe metodologjike të efektshme, në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto, më pas, do të përkthehen në Programet e Punës dhe Thirrjet për Propozim, të shpallura në Programet Specifike të FP7.
- Rritja e pjesëmarrjes së kërkuesve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në Projektet Europiane më interes të përbashkët dhe përfitimi nga zbatimi i

masave përkatëse për ngritjen e kapaciteteve në një nivel strukturor dhe individual, duke i shoqëruar me aktivitete të rrjetit.

Pjesëmarrësit në këtë Projekt

- Austri
- Shqipëri
- Kroaci
- Maqedoni
- Mali i Zi
- Serbi
- Bosnje & Hercegovinë
- Kosovë
- Slloveni
- Greqi
- Holland
- Spanjë
- Gjermani
- Turqi
- Bullgari
- Belgjikë
- Itali

Centre for Social Innovation (ZCI) - Qendra për Inovacion Social - Vjen, AUSTRI është Koordinatore e Projektit.

CIP - (*Competitiveness and Innovation Programme*)

Programi i Konkurrencës dhe Inovacionit.

‘Programi i Konkurrencës dhe Inovacionit’, bazohet në vendimin Nr 1639/2006/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian, të datës 24 Tetor 2006, me anë të të cilit u krijua ky program i cili do të veprojë nga 2007-2013, me një buxhet prej € 3621 milion eurosh.

Programi synon të mbështesë aktivitetet inovative dhe të sigurojë një akses më të mirë për financimin dhe shpërndarjen e shërbimeve mbështetëse të biznesit në rajone. Target grupi i këtij programi janë Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

CIP është i ndarë në tre Programe Operacionale:

- EIP**- (*The Entrepreneurship and Innovation Programme*). Program operacional i CIP për Sipërmarrjen dhe Inovacionin.
- ICT-PSP**- (*The Information Communication Technologies Policy Support Programme*). Program operacional i CIP për mbështetjen e politikave për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit.
- IEE**- (*The Intelligent Energy Europe Programme*). Programi operacional i CIP për Energjinë inteligjente në Europë.

CEI - (*Central European Initiative*) Iniciativa e Europës Qendrore është themeluar në 11 Nëntor 1989, në Budapest, si forumi i parë që promovon bashkëpunimin rajonal midis vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore.

Misioni kryesor i këtij forumi është nxitja e zhvillimit politik dhe socio-ekonomik në rajon, me qëllim shmangien e dallimeve në Europë.

CEI numëron 18 vende anëtare, ndër të cilat edhe Shqipëria, që prej vitit 1996. Në vitin 2006 Shqipëria ka kryesuar Presidencën e CEI. Kjo ka qenë një ngjarje e rëndësishme e politikës sonë të jashtme, vizibilitetit të vendit tonë dhe kapaciteteve tona organizative, e cila konfirmoi rolin aktiv të Shqipërisë në proceset e bashkëpunimit rajonal.

Instrumentat financuese të CEI:

- Aktivitetet bashkëpunuese;
- Programi i Shkëmbimit Know-How;
- Studimet Pas -diplomimit-Rrjeti Universiteteve;
- CERES- Programi i Bursave Kërkimore.

Pas përfundimit të CEI, në 2013, programi i ri do të jetë **COSME**- (*Competitiveness of enterprises and SMEs*) i cili do të veprojë për periudhën 2014-2020, me një buxhet të parashikuar prej 2.5 bilion Eurosh.

RRJETE KËRKIMORE-SHKENCORE

ESF - *(European Science Foundation)*

Fondacioni European për Shkencë është themeluar në vitin 1974, në Strasburg, si një organizatë e pavarur dhe jo qeveritare. Sot ky fondacion numëron 78 organizata anëtarë.

Qëllimi dhe roli kryesor i këtij Fondacioni është rritja e bashkëpunimit shkencor, në të gjithë Europën.

EEN - *European Enterprise Network*

Misioni i këtij Network-u është të ndihmojë bizneset e vogla, të përfitojnë sa më shumë nga mundësitë e biznesit që i ofrohen në Bashkimin European.

KEN - *(Knowledge Economy Network)*

KEN është një rrjet i cili ka si mision krijimin e një platforme për zhvillimin e njohurive të shoqërisë, me theks të veçantë në kapitalin njerëzor. KEN ka pikëpamje globale në shërbim të të gjithë anëtarëve të biznesit, akademisë, organizatave jo-qeveritare, qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare.



TERMA TEKNIK FP7

CORDIS - (*The Community Research and Development Information Service*)

“CORDIS” është faja zyrtare e internetit për të gjitha Programet Europiane të Kërkimit dhe Zhvillimit.

PARTICIPANT PORTAL PP- (*Participant Portal*)

“Portali i Pjesëmarrësve” është një link në “CORDIS” i cili u vjen në ndihmë të gjithë pjesëmarrësve në projekte, të menaxhojnë propozimet dhe projektet, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.

Ky “Portal” ofron shumë shërbime on-line, në kuadër të FP7. Nëpërmjet këtij Portali çdo pjesëmarrës, mund të përditësohet me të rejat e fundit në FP7, mund të marrë informacion mbi Propozimet apo Projektet e tij, mund të njoftohet për Thirrje të reja për Propozim, apo të aplikojë për këto Thirrje.

ECAS- (*European Commissions Authentication Service*)

“Shërbimi i Vërtetimit i Komisionit Europian” nënkupton shërbimin on-line të Komisionit Europian, me anë të të cilit bëhet regjistrimi i organizatave kërkimore, për marrjen e një emri identifikimi dhe passwordi në “CORDIS”, për të kaluar pastaj në marrjen e PIC (*Participant Identification Code*) dhe për të arritur në dërgimin e Projekt - Propozimeve, nëpërmjet EPSS-së.

EPSS- (*Electronic Proposals Submission System*)

“Sistemi Elektronik i dërgimit të Propozimit”.

Ky sistem, lejon koordinatorët e projektit të përgatisin dhe të dorëzojnë propozimin e tyre on-line, nëpërmjet internetit. Sistemi operon 7 ditë në javë, 24 orë në ditë, falas për të gjithë pjesëmarrësit, duke shmangur koston, apo problemet që mund të krijojë dorëzimi i projekt-propozimit në letër, me anë të postës. EPSS i jep mundësi propozuesve të krijojnë propozimin e tyre tërësisht on-line pa ruajtur dokumente, në kompjuterin e tyre personal.

PIC - (*Participant Identification Code*)

“Kodi i Identifikimit të Pjesëmarrësit”.

PIC është një kod unik 9 shifror, për identifikimin e pjesëmarrësve në çdo fazë të procesit, në menaxhimin e programeve të Komunitetit European. Pjesëmarrësit nuk e kanë të nevojshme të dërgojnë informacione ligjore dhe financiare shtesë, apo dokumente mbështetëse në çdo kohë që ato dërgojnë propozimin apo negociojnë. Ata, thjesht, duhet të paraqesin numrin PIC.

LEAR - (*Legal Entity Appointed Representative*)

“Përfaqësuesi i Emëruar i Entitetit Ligjor” nënkupton personin, i cili brenda një entiteti ligjor, kryen detyra, mban përgjegjësi dhe ka të drejta të cilat lidhen me korrespondencën e këtij entiteti me Drejtorinë e Përgjithshme të Kërkimit dhe Inovacionit, pranë Komisionit European, për çështje të caktuara.

WORK PROGRAMME FP7 - (*Work Programme*)

“Programet Vjetore të Punës” janë planet e hollësishme për zbatimin e programeve të veçanta, temat kërkimore dhe aktivitete të tjera në FP7. Ata specifikojë objektivat shkencore-teknike, ekonomike dhe shoqërore të çdo aktiviteti. “Programet Vjetore të Punës” projektojnë një “hartë” të planifikimeve për thirrje për propozim.

CALL FOR PROPOSAL - “Thirrja për Propozim” nënkupton hapjen e procedurave për aplikim për Programe, apo Projekte të ndryshme.

“Thirrjet për Projekt Propozime” për “Programin e Shtatë Kuadër” shpallen në Programin Vjetor të Punës, i cili përmban detaje për temat, kohën dhe implementimin e tyre. Procesi i projekt-propozimit diktohet nga “Thirrja për Propozim”.

“Thirrjet” në rastin e “Programit të Shtatë Kuadër” shpallen 2-3 herë në vit dhe afati kohor i tyre varion nga 1-6 muaj, pas shpalljes (zakonisht 3 muaj). Thirrja e specifikon qartë çdo gjë që kërkohet të përfshihet në projekt. Thirrjet shpallen në “Revistën Zyrtare” të BE-së (Official Journal of the European Union) dhe materialet përkatëse shpallen në “CORDIS”.

CALL FICHE - Fisha e Thirrjes është dokumenti bazë i “Thirrjes për Propozim”. Në të përcaktohet qartë Thirrja, Tema, Buxheti, Kohëzgjatja, Skema e Financimit, nëse projekti është “Një stad” apo “Dy Stad”.

FUNDING SCHEME - Skemat e financimit janë mënyrat në bazë të të cilave financohen projektet. Në FP7 kemi tre lloje skemash financimi :

- Projekte Bashkëpunuese – Janë skemat më të shpeshta, sepse ato financojnë aktivitete kërkimore. Përdoret më tepër në programet Specifike të Bashkëpunim dhe Kapaciteteve. Collaborative Projects- (Small or STREP) fokus shumë të mprehtë; Plan Pune strikt që nuk pritet të ndryshojë gjatë kohëzgjatjes së projektit.
- Collaborative Projects- (Large projects-Integrated Projects) - adresohen në shumë çështje. Konsortiumi ka autonomi të ndryshojë Planin e Punës dhe numrin e pjesëmarrësve.
- Rrjetet e Ekselencës - Organizatat ndërmarrin projekte të përbashkëta të grupeve kërkimore, duke organizuar aktivitete të përbashkëta të integruara në një fushë të caktuar. Bashkëpunim afatgjatë dhe angazhim zyrtar për të integruar burimet.
- Projekte Koordinuese dhe Mbështetëse - Përdoret në të gjitha Programet Specifike të FP7. Mbështetëse- financon studime, workshope, konferenca. Cordis IPR-Helpdesk është financuar nga kjo lloj skeme. Koordinim- nuk financojnë kërkim shkencor. Financon rrjetet Europiane.

WORK PACKAGE - Paketa e Punës.

Të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren nga një projekt ndahen në paketa pune.

Paketat e punës përcaktojnë:

- Titullin e paketës, (titulli varet nga struktura e ndarjes së punës);
- Tipin e aktivitetit;
- Drejtuesin e Paketës;
- Muajt për çdo person;
- Muajin e fillimit të projektit;
- Muajin e mbarimit.

CONCORTIUM AGREEMENT (CA) - Kjo është një marrëveshje midis partnerëve e cila përcakton:

- si do menaxhohet projekti;
- si do të ndahet puna;
- si do të menaxhohen konfliktet;
- si do të vendoset pronësia e pronës intelektuale.

Marrëveshja e Konsortiumit është e nevojshme për të gjitha projektet e financuara nën Programin e Shtatë Kuadër, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Thirrjen për Propozim.

Komisioni Europian nuk është pjesë e Marrëveshjes së Konsortiumit dhe nuk përcakton termat apo kushtet e kësaj marrëveshje, megjithatë në përputhje me Nenin 24 të Rregullave të Pjesëmarrjes, Komisioni ka krijuar dhe publikuar udhëzime jo detyruese në formë checkliste për të nxjerrë në pah disa çështje kryesore që duhet të përmbajë Marrëveshja e Konsortiumit dhe mënyrën sesi këto çështje i adresohen pjesëmarrësve.

Marrëveshja e Konsortiumit mund të marrë formë të ndryshme ligjore.

GRANT AGREEMENT (GA) - Marrëveshja e Grantit - nëse propozimi është vlerësuar në mënyrë të suksesshme, Komisioni Europian fillon negociimet e Marrëveshjes së Grantit me konsortiumin. Nëse negociimet janë të suksesshme, KE nënshkruan, Marrëveshjen e Grantit me Koordinatorin e Projektit.

NCP - (*National Contact Point*)

Pika Kombëtare e Kontaktit.

Në FP7, Pikat Kombëtare të Kontaktit veprojnë sipas fushave. Çdo Pikë Kombëtare Kontakti mbulon një fushë të FP7-tës.

SME - (*Small Medium Enterprises*)

Sipërmarrje të Vogla e të Mesme.

ICT - (*Information and Communication Technologies*)

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit.

IT - (Information Technologies)

Teknologjitë e Informacionit.

IPR - (Intellectual Property Rights)

Të drejtat e Pronës Intelektuale përcaktojnë:

1. Në cilat kushte kërkuesit do të shkëmbejnë njohuritë e tyre ekzistuese?
E drejta e Aksesit –Konfidencialiteti
2. Kush do të jetë pronari i rezultateve të reja?
Ownership – Joint ownership
Pronësia-Bashkëpronësia
3. Kush do t'i shfrytëzojë këto rezultate dhe si?
Protection – Use- Dissemination
Mbrojtja –Përdorimi – Shpërndarja

CLUSTER - Një grup i Projekteve për Kërkim/Teknologji dhe Zhvillim dhe/ose aksione të tjera me bashkëfinancim dhe/ose masa shoqëruese që i adresohen një teme apo fushe interesi të përbashkët.

DISSEMINATION - “Shpërndarja” nënkupton shpërndarjen aktive dhe/ose pasive të informacionit në lidhje me një projekt të caktuar –kjo është e detyrueshme në shkallë të ndryshme në çdo projekt. Mund të shikohet gjithashtu si një mënyrë e fshehur e marketingut.

SOCIAL INNOVATION - “Inovacioni Social” - nënkupton aktivitetet dhe shërbimet inovative të cilat janë të motivuara nga qëllimi i arritjes së një nevoje sociale dhe janë zhvilluar dhe shpërndarë kryesisht nga organizata të cilat kanë qëllime sociale.

SMART SPECIALIZATION - “Specializimi Smart” - është një princip i rëndësishëm i politikës dhe koncept i politikave inovative. Ai promovon efikasitet, efektivitet dhe përdorim të frytshëm të investimeve publike. Mbështet vendet dhe rajonet në forcimin e kapaciteteve inovative, duke fokusuar burimet njerëzore dhe financiare në disa fusha globalisht konkurruese, me qëllim rritjen ekonomike dhe prosperitetin.



“PAS FP7-ta”

EUROPE 2020 STRATEGY - Në 3 Mars 2010, Komisioni European ka miratuar Strategjinë “Europa 2020”.

Kjo strategji fokuson 3 prioritete:

- **Zhvillim të shpejtë**- zhvillimi i një ekonomie të bazuar në njohuri dhe inovacion;
- **Zhvillim të qëndrueshëm** - promovimi i më shumë burimeve efikase dhe i një ekonomie të gjelbër dhe konkurruese;
- **Zhvillim përfshirës**- nxitjen e një ekonomie të lartë punësimi duke marrë parasysh shpërndarjen sociale dhe territoriale.

HORIZON 2020 - Me përfundimin e FP7 –tës në 2013, programi i radhës është “Horizon 2020”.

Ky Program do të veprojë për një periudhë kohore nga 2014 deri në 2020, me një buxhet prej 80 bilion Euro.

Programi i ri i Bashkimit European për Kërkim dhe Inovacion ka qëllim arritjen e një zhvillimi të ri dhe ngritjen e nivelit të punësimit në Europë. “Horizon 2020” ofron një thjeshtëzim të madh të procedurave, vetëm nëpërmjet një pakete rregullash. Kjo paketë e vetme rregullash do të kombinojë të gjitha financimet e kërkimit dhe inovacionit, të cilat deri në këtë periudhë realizohen nga Programet Kuadër (FPI-FP7) nga CIP Programi i Konkurrencës dhe Inovacionit dhe nga Instituti European për Teknologji dhe Inovacion. “Horizon 2020” nënkupton: ZHVILLIM & PUNËSIM.

“Horizon 2020” konsiston në tri objektiva kryesore:

- Shkencë ekselente;
- Industri konkurruese;
- Shoqëri më e mirë.



TERMINOLOGJI

EU COMMISSION - Komisioni European, trupi ekzekutiv i Bashkimit European është një nga tre institucionet kryesore të Bashkimit European.

Roli kryesor i Komisionit European është të propozojë dhe implementojë legjislacione dhe të mbikëqyrë traktate të BE-së, të cilat formojnë bazën ligjore të BE-së.

DG RESEARCH & INNOVATION - Drejtoria e Përgjithshme e Kërkimit dhe Inovacionit pranë Komisionit European.

MOU - (*Memorandum of Understanding*)
Memorandumi i Mirëkuptimit.

MEMBER STATES - 27 Vendet Anëtare të Bashkimit European.

ASSOCIATED COUNTRIES - Vendet e asociuara të cilat, në bazë të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik, kanë të drejta të plota dhe detyrime për të marrë pjesë në Programet Komunitare.

CANDIDATE COUNTRIES - Janë vendet të cilat janë në proces për t'u bërë anëtare të Bashkimit European.

THIRD COUNTRIES - “Vendet e Treta” janë vendet jo në kuptimin e vendeve të Botës së Tretë, por vendet të cilat nuk janë as anëtare, as të asociuara, as vende kandidatë të Bashkimit European si: SHBA, Kina, Japonia, India etj.

ERC - (*European Research Council*)

“Këshilli European i Kërkimit” ka një pozicion unik në financimin e kërkimit shkencor European.

ERC është një institucion lider në financimin e shkencës, që mbështet kërkimin në nivelet më të larta të ekselencës, duke operuar në standardet botërore. Në përputhje me Strategjinë e BE-së ‘EUROPA 2020’ për një rritje të shpejtë,

të zgjuar dhe të qëndrueshme, ERC promovon ekselencën, dinamizmin dhe kreativitetin në kërkimin European, duke nxitur tërheqjen e kërkuesve dhe kompanive më të mira në Europë.

Grantet ERC jepen për financime të skemave ‘*Provë e Konceptit*’ (Proof of Concept) që themelojnë potencialin inovator të ideve. Këto aktivitete zbatohen nëpërmjet Aksioneve Koordinuese dhe Mbështetëse.

LISBON STRATEGY - “Strategjia e Lisbonës” është një aksion dhe plan zhvillimi i Bashkimit European.

Qëllimi i kësaj strategjie është që ta bëjë Bashkimin European më dinamik, me një ekonomi konkurruese, të bazuar në njohuri për një rritje të qëndrueshme ekonomike, me më shumë vende pune dhe një kohezion më të madh social dhe respekt mjedisor.

MODELI I MARRËVESHJES SË GRANTIT

Web site për Modelin e Marrëveshjes së Grantit është:
http://cordis.europa.eu/fp7/calls-grant-agreement_en.html

Komisioni European ofron Modele Grant Agreement, në varësi të Programeve specifike të FP7. Këto Modele të Marrëveshjes së Grantit sipas Programeve specifike mund t'i gjeni në www.finance-hepdesk.org

MODELI I MARRËVESHJES SË GRANTIT

ANEKSET	EMRI	ROLI
	Core Grant	Kjo pjesë e “Marrëveshjes së Grantit” përmban informacion që është specifik për projektin. Këtu përfshihen : Data e fillimit dhe Kohëzgjatja, Kontributi Financiar i BE-së, Periudhat e Raportimit, Listë e Pjesëmarrësve, dhe Klauzolat e veçanta.
Aneks I	Aneksi Teknik	Ky aneks përshkruan punën që është bërë për projektin. Kjo është e bazuar në propozimin origjinal fillestar dhe përmban; Paketat e Punës, Deliverables, Milestones etj.
Aneks II	Dispozita të Përgjithshme	Aneksi II përmban rregullat bazë më të rëndësishme ligjore dhe financiare. Ky dokument është i bazuar në Rregullat e Pjesëmarrjes.
Aneks III	Specifike për Skemën e Financimit	Aneksi III përmban dispozita ekstra për grandet e ndryshme që janë përdorur në Framework 7
Aneks IV	Forma A	Forma A është e nënshkruar nga çdo partner në konsortium. Ky është dokumenti zyrtar që sjell pjesëmarrësit në projekt.
Aneks V	Forma B	Forma B përdoret kur pjesëmarrësit i bashkohen projektit pas datës së fillimit të tij.
Aneks VI	Forma C	Forma C përdoret për të “kërkuar” kontributin financiar.

Aneks VII	Forma D	<p>Çertifikata e Deklarimit Financiar Një Çertifikatë e Deklarimit Financiar do të dërgohet për të kërkuar pagesën e përkohshme dhe pagesën finale kur shuma e kontributit financiar të komunitetit marrë nga përfituesi, bërë në formën e rimbursimit të kostos është e barabartë ose më e madhe se 375.000, si dhe kur për të gjitha pagesat e mëparshme nuk është dërguar një Çertifikatë Kostoje.</p>
	Forma E	<p>Çertifikata e Metodologjisë. Komuniteti mundet brenda diskrecionit të tij të pranojë një kërkesë nga përfituesi për të dërguar një çertifikate për metodologjinë dhe të kontrollojë sistemin e përdorur për përgatitjen e kërkesës së tij në lidhje me personelin dhe kostot administrative, në formën e një përkrahimi të detajuar të verifikuar si faktual nga auditorët e jashtëm.</p>

ANEKS II DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizimet

PJESA A ZBATIMI I PROJEKTIT

1. Parimet e Përgjithshme

- Organizimi i konsortiumit dhe roli i koordinatorit
- Detyrimet specifike për çdo përfitues

2. Raportimi dhe Pagesat

- Raportet dhe Deliverables
- Aprovimi i Raporteve dhe deliverables, afatet për pagesat
- Modalitetet e pagesës

3. Zbatimi

- Nënkontraktimi
- Ndërprerja e Projektit
- Konfidencialiteti dhe Informacioni i klasifikuar
- Komunikimet e të dhënave për vlerësim, impakti, standardizimi
- Informacioni për Shtete Anëtare dhe Vendet e Asociuara
- Informacioni dhe Komunikimi
- Të dhënat personale

PJESA B DISPOZITAT FINANCIARE

1. Dispozitat e Përgjithshme financiare

- Kostoja Ligjore e Projektit
- Identifikimi i kostove direkte dhe indirekte
- Kufiri i sipërm i financimit
- Faturat e Projektit
- Kontributi Financiar i Komunitetit
- Interesi i parafinancimit

2. Fondi i Garancisë

- Përgjegjësia financiare
- Fondi i garancisë

3. Kontrollet, rikuperimi dhe sanksionet

- Auditi dhe kontrollet financiare
- Rishikimet Teknike
- Likuidimi i dëmeve dhe penaltitetet financiare
- Rimbursimet tek Komisioni dhe urdhrat e rikuperimit

PJESA C EDREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE, PËRDORIMI DHE SHPËRNDARJA

1. Foreground

- Pronësia
- Transferimi
- Mbrojtja
- Përdorimi
- Shpërndarja

2. Të drejtat e Aksesit

- Parimet
- Të drejtat e Aksesit për zbatim
- Të drejtat e Aksesit për përdorim

3. Dispozitat Finale

- Kërkesa për ndryshime dhe përfundimi me iniciative të konsortiumit
- Aprovimi i ndryshimeve dhe përfundimi me kërkesë të konsortiumit
- Thirrjet konkurruese
- Përfundimi i Marrëveshjes së Grandit dhe pjesëmarrja e përfituesve
- Kontributi financiar pas përfundimit dhe pasoja të tjera të këtij përfundimi
- Forca Madhore
- Detyrat
- Përgjegjësia



MODELI I MARRËVESHJES SË KONSORTIUMIT

Marrëveshja e konsortiumit negociohet midis partnereve dhe lidhet midis tyre. Nënshkrimi i marrëveshjes specifikohet në Thirrjen për Propozim.

IPR- help Desk www.ipr-helpdesk.org

Finance help Desk www.finance-helpdesk.org

1. PËRSHKRIM

“Marrëveshja e Konsortiumit” është e nevojshme për të gjitha projektet e financuara nën “Programin e Shtatë Kuadër”, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në “Thirrjen për Propozim”.

Komisioni Europian nuk është pjesë e ndonjë Marrëveshjeje Konsortiumi dhe nuk përcakton termat, apo kushtet e kësaj marrëveshje, megjithatë në përputhje me Nenin 24 të Rregullave të Pjesëmarrjes, Komisioni ka krijuar dhe publikuar udhëzime jo detyruese në formë checkliste për të nxjerrë në pah disa çështje kryesore që duhet të përmbajë Marrëveshja e Konsortiumit dhe mënyrën sesi këto çështje i adresohen pjesëmarrësve.

“Marrëveshja e Konsortiumit” mund të marrë forma të ndryshme ligjore. Avantazhet dhe disavantazhet e çdo forme të caktuar ligjore, duhet të shqyrtohen me kujdes nga pjesëmarrësit dhe të përcaktohen në përputhje me nevojat e Konsortiumit. Përveç rastit kur “Thirrja për Propozim” përcakton se nuk është e nevojshme “Marrëveshja e Konsortiumit”, duhet në princip të negociohet dhe nënshkruhet përpara fillimit të projektit.

2. PALËT

Në “Marrëveshjen e Konsortiumit” duhet të identifikohet çdo palë pjesëmarrëse.

3. HYRJA

Përmbledh kontekstin dhe qëllimin e “Marrëveshjes së Konsortiumit” (duke përfshire titullin, akronimet nëse aplikohen, projektin edhe numrin e “Marrëveshjes së Grantit”, nëse dihet).

4. PËRKUFIZIMET

Duhet përcaktuar të gjithë termat e rëndësishëm të përdorur në M. K. si edhe termat e përkufizuara në rregullat e pjesëmarrjesi dhe në “Marrëveshjen e Grantit”. Këto të mos përsëriten në MK, por të bëhet referim në këto dokumente.

5. SUBJEKTI

Përshkruani me qartësi subjektin e “Marrëveshjes së Konsortiumit”, me referencë në “Marrëveshjen e Grantit”, kur është e nevojshme.

6. DISPOZITAT TEKNIKE

Nëse nuk janë përshkruar në Aneksin I të “Marrëveshjes së Grantit”, duhet të jepen në këtë Seksion detaje të mëtejshme të rëndësishme.

6.1 Detyrat e seciles palë

Jep një përkufizim të qartë të detyrave që secila palë synon të kryejë, ndoshta duke iu referuar dokumenteve teknike, siç përcaktohet në Aneksin I të “Marrëveshjes së Grantit”.

Përshkruaj marrëdhënien ndërmjet detyrave dhe palëve dhe ndonjë ndërvarësi të mundshme të tyre.

6.2 Burimet jo financiare të vëna në dispozicion të projektit

Jep një pasqyrë të detajuar të burimeve financiare të tilla si:

- Burimet njerëzore (nr i personave, pjesëmarrësit kyç, një listë e plotë e tyre, nëse është e mundur, kualifikimet, delegimet)
- Pajisje dhe objekte (numri, natyra, vendi)
- Dokumentacion, ose informacione të tjera si p.sh (projekt-plane, manuale, llogaritje, prototipa, informacione mbi të drejtën e pronësisë intelektuale)
- Kontributet e sponsorizuesve, apo ndonjë pale tjetër të tretë (p.sh. nënkontraktorët, ose filiale)

6.3 Plani kohor i projektit

Përcakto skedën kohore për kryerjen e detyrave të ndërlidhura dhe për qëllime planifikimi, p.sh ku dhe si burimet do të vihen në dispozicion.

Është e rekomandueshme që, në interes të palëve, ata të mos vendosin skeda

kohore të pakthyeshme, nëse nuk janë absolutisht të sigurt se do t'i përmbahen asaj dhe duhet të përfshijnë një plan emergjence për vonesat dhe mungesat në orare.

Nga ana tjetër, duhet të garantohet një përputhshmëri minimale me oraret, siç është diskutuar në “Dispozitat Menaxhuese”.

6.4 Ndryshimet

Përcaktojnë dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshimet në projekt.

“Marrëveshja e Konsortiumit” mund të rregullohet, ose madje të fshihet e gjitha, sipas progresit të punës dhe në varësi të situatës.

Për të përballuar situata të paqëndrueshme, është e këshillueshme të sigurohet një procedure fleksibile për ndryshime në specifikimet fillestare. Kjo mund të përfshijë përfundimin e detyrave të caktuara, tërheqjen e palëve të caktuara, përfshirjen e palëve të reja. Për të shmangur konfliktet, kushtet dhe procedurat, duhet të jenë qartësisht të shprehura.

7. DISPOZITAT MENAXHUESE

Përshkruaj dispozita që kanë të bëjnë me menaxhimin e projektit (organet drejtuese, detyrat, vendimmarrja).

7.1 Koordinimi dhe menaxhimi

Krijo një strukturë koordinuese (mund të quhet Komitet Drejtues, Komitet Koordinues, Komitet Menaxhimi dhe mund të ndahet në grupe të tilla si financiare, teknike, ligjore, etj) dhe me detyra të tilla si :

- për të përcaktuar, ndarë dhe zhvilluar detyrat;
- për të kontrolluar ecurinë e punës;
- për të koordinuar ekipet e kërkimit shkencor;
- për të koordinuar përgatitjen e raporteve (teknike, financiare, etj);
- për të këshilluar dhe drejtuar partnerët mbi zhvillimet e nevojshme për projektin;
- për të lejuar shkëmbimin e informacionit zyrtar midis partnerëve.

Puna e këtij Komiteti përkthehet në një punë menaxhuese të përditshme dhe në detyrat përfaqësuese të Koordinatorit.

Komitete të tjera mund të krijohen, nëse është e nevojshme dhe të raportojnë tek Komiteti Drejtues, apo Koordinues. Mund të krijohen Komitete të përbashkëta për t'u marrë me çështje të tilla si:

- Përbërja e partnerëve;
- Roli i tyre (drejtues, menaxhimin teknik, financiar, IPR,);
- Procedurat organizative (p.sh orari dhe thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme);
- Zgjidhjen e konfliktit (duke përfshirë edhe raste të abuzimit të pushtetit në kuadër të projektit).

7.2 Kompetencat dhe përgjegjësit

“Marrëveshja e Konsortiumit” duhet të përcaktojë me kujdes çdo organ të krijuar dhe për çdo person, të cilit i janë besuar detyra të caktuara si:

- Kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Procedurat operative (përgatitja e mbledhjeve, rendin e ditës, vendimet e kryesisë, minuta, vota, etj);
- në rastin e organeve, organizimin e tyre (përbërja, kompetencat e secilës palë, mënyrën e vendimmarrjes, me shumice votash, unanimisht, votimi dhe e drejta e vetos).

Për të shmangur procedurat komplekse, për ndryshime të vogla, (sidomos për ato ndryshime të cilat nuk ndikojnë në ndryshimin e “Marrëveshjes së Grantit”) palët mund të parashikojnë një proces aprovimi të veçantë, në varësi të ndryshimit që kërkohet të kryhet.

7.3 Vazhdimësia dhe mbikëqyrja

Përshkruaj si do të realizohet ndjekja dhe mbikëqyrja e Projektit.

Ndjekja dhe mbikëqyrja e Projektit duhet të menaxhohet nga Komiteti Drejtues, duke përfshirë këtu:

- Takime të shpeshta për progresin e Projektit(duke filluar nga një herë në muaj, deri në tri herë në muaj);
- Raporte të shpeshta për progresin teknik dhe financiar (veprimet e përfunduara dhe rezultatet e fituara);
- Mbledhje të jashtëzakonshme.

8. DISPOZITA FINANCIARE

(Përtej atyre të përfshira në “Marrëveshjen e Grantit” dhe anekset e saj)

8.1 Plani financiar

Përshkruaj me detaje planin financiar duke përfshirë:

- Një vlerësim të detajuar të kostos për çdo palë dhe të kostot së përgjithshme;
- Kontributi financiar i pritshëm nga Komuniteti European dhe shpërndarja e tij;
- Burimet e jashtme financiare të palës së tretë (nga autoritetet, bankat, kapitale dhe sqarime se a duhet të konsiderohet fatura të projektit);
- Shpenzimet dhe plani i financimit;
- Buxheti vjetor.

Nëse është e nevojshme, mund të përfshihen detaje të tjera në lidhje me planin financiar të projektit

8.2 Pagesat e përbashkëta

Ka të bëjë me pagesat e ndërsjellta dhe shpenzimet e më shumë se një pale në projekt.

Në rrethana të caktuara, dy ose më shumë palë, mund të kryejnë shpenzime të përbashkëta (personel, pajisje).

Është e nevojshme që të përcaktohet qartë procedura që ka të bëjë me pagesën e këtij lloj shpenzimi, nga çdo palë në “Marrëveshjen e Konsortiumit” dhe të identifikojë qartë raportimin në Komision, veçanërisht, për sa më poshtë:

- rimbursimet dhe metoda e rimbursimit;
- llogaria e përbashkët dhe kushtet për pagesën e fondeve;
- kushtet e pagesës;
- monedha;
- ndikimi i normave të këmbimit dhe shpenzimet e transfertës bankare;
- pagesa e taksave;
- interesi, nëse ka;

Identifikimi i kostos për aktivitetet menaxhuese, përveç atyre të parashikuara në “Marrëveshjen e Grantit”.

8.3 Kostot për aktivitetin menaxhues

Përcakto kostot që kanë të bëjnë me menaxhimin e projektit.

Kostot për menaxhimin administrativ dhe financiar të konsortiumit (p.sh. kostot që lidhen me takime, kosto që lidhen me certifikatën e detyrueshme të pasqyrave financiare) do të rimbursohen nga kontributi financiar i komisionit, deri në 100% të shpenzimeve të bëra.

8.4 Ndryshimet

Përcakto dispozitat që kanë të bëjnë me ndryshime, në aspektin financiar të projektit. “Marrëveshja e Konsortiumit” duhet të qartësojë dhe specifikojë kushtet, përsa i përket modifikimeve financiare (sidomos, ato në lidhje me transfertat e buxhetit midis përfituesve) dhe pasojat e tyre në organizimin e bashkëpunimit.

9. DISPOZITAT NË LIDHJE ME TË DREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE, SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI

Përshkruaj dispozita shtesë në lidhje me të drejtat e pronës intelektuale, përdorimi dhe shpërndarja. Parimi i përgjithshëm që zbatohet për hartimin e këtyre dispozitave është sigurimi i fleksibilitetit dhe mekanizmave eficientë, për të mbështetur bashkëpunimin midis palëve, për të inkurajuar mbrojtjen dhe përdorimin në maksimum të rezultateve të kërkimit (*foreground*) dhe në të njëjtën kohë për të siguruar shpërndarjen e shpejtë të këtyre rezultateve.

Më tepër informacion, mund të gjendet në **“Guide to Intellectual Property Rights for FP7 projects”**.

9.1 Pronësia e rezultateve

Ka të bëjë me pronësinë e rezultateve të zhvilluara në projekt.

Në rastin e pronësisë së përbashkët, pronarët e bashkëpronësisë duhet të nënshkruajnë një marrëveshje në lidhje me ndarjen dhe kushtet e ushtrimit të bashkëpronësisë.

Një marrëveshje e tillë mund të përfshijë çështje të tilla si menaxhimin e vështirësive të kësaj bashkëpronësie, në varësi të situatave të ndryshme që mund të dalin gjatë kësaj kohe.

Nëse ruhet bashkëpronësia, palët mund të bien dakord për:

- ndarjen territoriale në bazë të së cilës, njëra palë ka në pronësi shpikjen vetëm në disa vende dhe palët e tjera, janë të lira ta regjistrojnë atë në vende të tjera të caktuara;
- një formë të ndarjes së tregjeve, në bazë të së cilës njëra palë zotëron shpikjen vetëm në sektorë të biznesit në të cilat ajo është tashmë aktive;
- të ngritur një regjim në lidhje me mbrojtjen e së drejtës së pronës intelektuale (si, kur, shpenzimet për këtë mbrojtje, detyrimet e mundshme);
- për të ngritur një regjim për përdorimin (duke përfshirë licencën) nga pronarët e përbashkët.

Çështjet e bashkëpronësisë do të rregullohen një herë dhe për të gjithë, në “Marrëveshjen e Konsortiumit”, ose në marrëveshje të veçura për bashkëpronësinë, në varësi të situatave të ndryshme.

9.2 Transferimi i rezultateve

Ka të bëjë me transferimin e pronësisë (mënyra në të cilën jepet njoftimi, apo kundërshtimi për transferimin e pronësisë, palët mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për njoftim paraprak, në lidhje me transferimin e pronësisë, drejt palëve të treta të specifikuar në “Marrëveshjen e Konsortiumit” apo në Marrëveshje të veçanta, të lidhura midis tyre)

9.3 Mbrojtja e rezultateve

Ka të bëjë me mbrojtjen e rezultateve (procedura që duhet ndjekur duke marrë parasysh interesat legjitime të pjesëmarrësve të tjerë, rastet kur pronari nuk dëshiron të mbrohet, si të zgjidhen çështjet me aplikimet e mundshme për patentë, etj)

9.4 Përdorimi i rezultateve

Përcakton dispozitat, në lidhje me detyrimin për të përdorur rezultatet komercialisht, ose për t’i përdorur për kërkime të mëtejshme.

9.5 Shpërndarja, përfshirë edhe publikimin e rezultateve

Secili pronar duhet të sigurojë se rezultati (foreground) i tij është shpërndarë në mënyrën më të shpejtë të mundshme dhe duhet të njoftojë palët e tjera. “Marrëveshja e Konsortiumit” duhet të përmbajë dispozita për të siguruar

shpërndarje koherente (Foreground), gjithashtu edhe për periudhën specifike të noftimit, në ndryshim nga periudha e parashikuar në “Marrëveshjen e Grantit”.

9.6 E drejta e aksesit (licensat dhe të drejtat e përdorimit)

Plotëso kur është e nevojshme me regjimin e të drejtave të përdorimit, të parashikuar në “Marrëveshjen e Grantit”. (disa nga këto çështje mund të rregullohen edhe në marrëveshje të veçanta, sidomos kur kanë të bëjnë vetëm me disa prej palëve të “Marrëveshjes së Konsortiumit”).

Në përgjithësi “Marrëveshja e Konsortiumit” mund të:

- përcaktojë procedurë për kërkesën me shkrim në lidhje me të drejtën e përdorimit duke i bashkangjitur kësaj kërkesë pranimin e kushteve në lidhje me konfidencialitetin dhe përdorimin për qëllimin e synuar;
- përcaktimin e një procedure në lidhje me tejkalimin e mundshëm të të drejtave të përdorimit;
- përcaktojë nëse e drejta e përdorimit akordon të drejtën për të dhënë nën-licenca (në përgjithësi e drejta e përdorimit jepet pa të drejtën për të dhënë nën-licenca);
- të sigurojë të drejta aksesit *përdorimi më të favorshme*, sesa ato të parashikuara në “Marrëveshjen e Grantit” gjithmonë, në lidhje me qëllimin, ose të përcaktojë subjektet legjitime për të kërkuar të drejtën e aksesit.

10. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

10.1 Hyrja në fuqi e marrëveshjes së konsortiumit

Përcakton datën në të cilën “Marrëveshja” do të hyjë efektivisht në fuqi për të gjitha palët pjesëmarrëse në të.

10.2 Kohëzgjatja dhe përfundimi i marrëveshjes së konsortiumit

Ka të bëjë me kohëzgjatjen e “Marrëveshjes” dhe me shkaqet e përfundimit të parakohshëm të saj si dhe me çështje të tilla si:

- Kohëzgjatja e MK , në lidhje me kohëzgjatjen e M.G;
- Mundësia e rinovimit të heshtur dhe zgjatjes së saj;
- Përfundimi i menjëhershëm pas realizimit të plotë të projektit;
- Mbarimin para përfundimit, ose me përfundimin e plotë të M.G;

- Përfundimin e saj për shkak të shkeljeve;
- Pasojat e arsyeve të ndryshme të përfundimit.

10.3 Amendamentet e marrëveshjes së konsortiumit

Jep kushte të thjeshta dhe të qarta dhe procedurat për amendimin dhe rishikimin “Marrëveshjes së Konsortiumit” në lidhje me:

- Tërheqjen e palëve (tërheqja e një pale nuk do të thotë automatikisht përfundimin e M.K);
- Pranimin e palëve të reja;
- Përjashtimi i palëve (procedura që duhet ndjekur në këto raste dhe dispozitat në lidhje me detyrimet konfidenciale , pas largimit të një pale nga kjo “Marrëveshje”);
- Rishikimi i dispozitave të rëndësishme.

10.4 Konfidencialiteti

Përcakton detyrimet e konfidencialitetit dhe kufizimet e tij si p.sh:

- Kush informacion konsiderohet konfidencial;
- Hapat që do ndiqen si dhe procedurat që ndërmerren për të shënuar dhe transferuar informacionin konfidencial;
- Kujt mund t’i tregohet informacioni konfidencial dhe në cilat kushte;
- Periudhën gjatë së cilës duhet të respektohen detyrimet e konfidencialitetit.

10.5 Trajtimi i të dhënave dhe informacionit të klasifikuar, trajtimi i materialeve të rrezikshme

Për projektet kërkimore në fushën e sigurisë, palët duhet të vendosin rregulla të brendshme për të përcaktuar se si të trajtojnë, përdorin dhe transferojnë të dhëna dhe informacione të klasifikuara dhe material të rrezikshme. Çdo trajtim i tillë duhet të respektojë kufizimet ligjore përkatëse kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare. “Marrëveshja e Konsortiumit” mundet të përmbajë, gjithashtu, pasoja ligjore në rastet e problemeve të caktuara, apo mospërputhjes së palëve, përveç atyre klauzolave kontraktuale të parashikuara në “Marrëveshjen e Grantit”.

10.6 Shkeljet, papajtuesmeritë, përgjegjësia, dëmshperblimet dhe dënimet

Përcakton se çfarë përben një shkelje e detyrimeve që rrjedhin nga “Marrëveshja e Konsortiumit” dhe pasojat e këtyre shkeljeve.

- Procedura që duhet ndjekur (duke përfshirë këtu njoftimin për shkeljen e identifikuar dhe mundësinë për ta ndrequr brenda një periudhe të caktuar);
- Përgjegjësinë (kufizimet e mundshme/forca madhore) për dëmin e shkaktuar dhe dëmshpërblimin e këtij dëmi;
- Dënimet e mundshme (kushtet, procedura, kamat -vonesa për likuidimin dheve etj);
- Përfundimi i mundshëm i M.K

10.7 Mbijetesa

Përcakton se cilat dispozita i mbijetojnë kohëzgjatjes së “Marrëveshjes së Konsortiumit”, të tilla si:

- Konfidencialiteti, nëse është i aplikueshëm, informacionet e klasifikuara;
- Ligji i aplikueshëm dhe juridiksioni;
- Dispozitat për të drejtën e aksesit;
- Përdorimi i AKRONIMIT të projektit.

10.8 Pavlefshmëria e pjesëshme

Ka të bëjë me pasojat e pavlefshmërisë të disa prej dispozitave të “Marrëveshjes së Konsortiumit”.

10.9 Komunikimi

Përcakton mënyrën e njoftimeve dhe komunikimeve nën “Marrëveshjen e Konsortiumit” (këto mënyra mund të ndryshohen, në lidhje me qëllimin e caktuar).

10.10 Ligji i aplikueshëm dhe juridiksioni

Përcakton se cili ligj vepron në “Marrëveshjen e Konsortiumit” dhe cili juridiksion duhet të përdoret, në rastin e zgjidhjes së konflikteve.

Ligji i aplikueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet është, zakonisht, ligji i brendshëm i njëres prej palëve, ose ligji i cili është i zbatueshëm në një bazë nënligjore të “Marrëveshjes përkatëse të Grantit”.

Juridiksioni i zgjedhur për të zgjidhur konfliktet mund të jetë një gjykatë kombëtare, ose një mekanizëm alternativ i zgjidhjes së konflikteve si p.sh arbitrazhi. Nëse përcaktohet arbitrazhi si mënyrë e zgjidhjes së konflikteve,

atëherë “Marrëveshja e Konsortiumit” duhet të përcaktojë disa, ose të gjitha karakteristikat e procedurës që duhet ndjekur.

10.11 Numri i kopjeve, gjuha dhe procesi i nënshkrimit

Përcakton numrin e kopjeve të “Marrëveshjes së Konsortiumit” si edhe gjuhën, ose gjuhët (nëse përdoren më shumë se një gjuhë, duhet përcaktuar gjuha që do të mbizotërojë, në rast të mosmarrëveshjeve). Përcakton procesin e nënshkrimit.

11. DISPOZITA SPECIFIKE TË SKEMAVE TË FINANCIMIT

11.1 Projekte bashkëpunuese

- Projekte Bashkëpunuese të Mëdha.
- Projekte Bashkëpunuese të Vogla.

11.2 Rrjetet e ekselencës

- Aktivitetet e Programeve të Përbashkëta.
- Matja e integritit të burimeve të kërkimit dhe kapaciteteve.
- Shpërndarja e Kontributit Financiar/ Lump Sum.

11.3 Projektet e infrastrukturës së kërkimit

11.4 Aksionet e koordinimit dhe mbështetjes

11.5 Kërkime në dobi të grupeve specifike

Kërkime për SME, shoqata, si dhe kërkime për organizata të shoqërisë civile.

MODELE TË MARRËVESHJES SË KONSORTIUMIT

1. **DESCA** Version www.desca-fp7.eu
2. **EUCAR** Model Consortium Agreement <http://www.eucar.be/publications/EUCAR%20Consortium%20Agreement.doc/view>
3. **EICTA** model for the Consortium Agreement: http://www.ipr-helpdesk.org/controlador/documentos?seccion=listadoDocumentos&modo=listado&cod_nodo_padre=t_02.03.02&niveles_profundidad=1&len=en
4. **IMG4** Consortium Agreement <http://www.aerosme.com/nees/article.asp?article=250>



GUIDA PRAKTIKE – COST, EUREKA, MARIE CURIE

UDHËZUES APLIKIMI “BASHKËPUNIMI EUROPIAN PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI” COST



Përmbajtja e Lëndës

I - Programi Europian i Bashkëpunimit për Shkencë dhe Teknologji

- Çfarë është Programi i Bashkëpunimit Europian për Shkencë dhe Teknologji – COST?
- Çfarë financon Programi i Bashkëpunimit Europian për Shkencë dhe Teknologji – COST?
- Pjesëmarrja me statusin Vend Jo-COST
- Fushat (Domains) COST
- Aplikimi në Aksionet COST (me statusin Vend Jo-COST)
- Statuset e pjesëmarrjes në Aksionet COST
- Shkollat e Trajnimit COST
- Libraria COST

II - Lidhje të nevojshme

III- Anex I - Formulari i Aplikimit në Aksionet COST me statusin “Vend Jo-COST”

I - PROGRAMI EUROPIAN I BASHKËPUNIMIT PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI

○ Çfarë është Programi i Bashkëpunimit European për Shkencë dhe Teknologji - COST?

COST- Bashkëpunimi European për Shkencë dhe Teknologji- është një nga instrumentet më afatgjatë në mbështetjen e kërkuesve dhe kërkimit shkencor në Europë. COST është rrjeti i parë ndërqeveritar më i përhapur European me qëllim koordinimin e aktiviteteve kërkimore me financim kombëtar. COST - së bashku me Programin “EUREKA” dhe Programin “Kudër të BE-së” - është një nga tri shtyllat e iniciativave të përbashkëta kërkimore Europiane.

○ Çfarë financon Programi i Bashkëpunimit European për Shkencë dhe Teknologji - COST?

COST ofron mbështetje financiare për bashkëpunimin e grupeve specifike në Europë si dhe për koordinimin e aktiviteteve kërkimore të përfshira në ‘Aksione’. Mbështetja financiare përfshin koston organizimit të aktiviteteve të rrjetit: takime (koston e udhëtimeve, akomodimin, dietat ditore, etj), organizimin e konferencave, workshop-e, shkëmbime shkencore afatshkurtra, shkolla trajnimi disa- ditore, publikime etj.

COST nuk financon kërkimin shkencor në vetvete, kërkimi shkencor duhet të financohet nga instrumente kombëtarë.

○ Pjesëmarrja me Statusin ‘Vend Jo-COST’

Shqipëria në Programin COST ka statusin e një ‘Vendi Jo-COST’ dhe përfshihet në Politikën e ‘afër-fqinjësisë’ (‘near-neighbouring’). Për këto vende, COST financon deri në 2 kërkues nga i njëjti vend për të marrë pjesë në I Aksion. Kërkuesit nga këto vende mund të marrin pjesë në aktivitete të Aksioneve (takime, misione shkencore afat-shkurtra, shkolla trajnimi, konferenca me shpenzime financiare të mbuluara nga COST).

○ Fushat (Domains) COST

Si pararendës i kërkimit të avancuar shumë-disiplinor, COST luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e Sferës Europiane të Kërkimit ([European Research Area](#) - ERA).

COST plotëson objektivat dhe aktivitetet e Programeve Kuadër (EU Framework Programme-FP) duke krijuar një urë lidhëse për komunitetin shkencor në vendet e Europës. COST gjithashtu mbështet lëvizshmërinë e kërkuesve në të gjithë Europën dhe nxit ekselencën shkencore në **9 fusha kryesore**.

Këto Fusha (Domain) janë si vijon:



Biomedicine and
Molecular Biosciences



Earth System Science and
Environmental Management



Food and Agriculture



Information and Communication
Technologies



Forests, their Products
and Services



Transport and Urban
Development



Materials, Physics and
Nanosciences



Individuals, Societies,
Cultures and Health



Chemistry and Molecular
Sciences and Technologies

Në Programin COST, **Aksionet** janë projektet që zbatohen brenda 9 Fushave (Domaineve) të paracaktuara. Të drejtën për të iniciuar një Aksion e kanë vetëm vendet me Statusin Vend-COST. Aksionet kanë objektiva, qëllime dhe përfundime të mirëpërcaktuara. Këto përshkruhen në “Memorandumin e Mirëkuptimit” (MoU) i cili firmoset vetëm nga vendet pjesëmarrëse me statusin “Vend-COST”.

○ Aplikimi në Aksionet COST (me statusin ‘Vend Jo-COST’)

Çdo kërkues shqiptar i cili ka kryer një studim/kërkim shkencor duke përdorur fondet shtetërore (nga institucioni që ai përfaqëson, ose një institucion tjetër

financues kombëtar) mund të aplikojë për të marrë pjesë në një nga “Aksionet COST”.

Kërkuesit shqiptarë nuk mund të iniciojnë “Aksione COST”, por ata mund t'i bashkohen një “Aksioni COST”, i cili ka nisur. Duke qenë se “Aksionet COST” kanë një jetëgjatësi të parapërcaktuar, sugjerohet që “Aksioni” për të cilin do të aplikohet, të jetë një, ose disa vjet para afatit të përfundimit, me qëllim që pjesëmarrësi të ketë kohë në dispozicion të ndjekë disa nga takimet që organizohen nga “Aksioni” (rreth 2-3 herë në vit).

“Aksionet COST” kanë një fond të parapërcaktuar që mbulon pjesëmarrjen e kërkuesve nga “Vende Jo-COST”, kështu që aplikimi i kërkuesve me status “Jo-COST” (si Shqipëria) është i parashikuar dhe i mirëpritur në çdo “Aksion”.

Hapat që duhen ndërmarrë për të aplikuar në COST:

- 1- Në faqen Zyrtare COST gjeni Fushën (Domain) që ju mbulon;
- 2 - Brenda kësaj Fushe përcaktoni Aksionin që i përshtatet punës suaj kërkimore;
- 3 - Lexoni përshkrimin e Aksionit dhe “Memorandumin e Mirëkuptimit” me qëllim që të kuptoni më mirë përmbajtjen dhe pjesëmarrësit e tjerë të Aksionit;
- 4 - Gjeni informacione mbi kohëzgjatjen e Aksionit (Action Information) dhe sigurohuni që ka kohë të mjaftueshme për të aplikuar;
- 5 - Gjeni kontaktet e drejtuesit të Aksionit (Chair of the Action) dhe Drejtuesit Shkencor (Science Officer) dhe drejtojuni atyre aplikim tuaj.
- 6 - **Letra e Interesit** është një nga dokumentet bazë të aplikimit tuaj. Ajo duhet hartuar dhe firmosur nga eprori juaj.
- 7 - Plotësoni **Formularin e Aplikimit** për pjesëmarrjen e “Vendeve jo-COST” dhe përcaktoni Grupet e Punës (Working Groups) në të cilat ju do të kontribuoni dhe mënyrën se si. (Aneks I)
- 8 - Bashkëlidhni aplikimit një **CV personale të përditësuar** në gjuhën angleze
- 9 - Aplikoni nëpërmjet postës elektronike dhe bashkëlidhni dokumentet e sipërpërmendura. Kërkesën për aplikim duhet ta drejtoni tek Drejtuesi i Aksionit dhe Drejtuesi Shkencor (e-mailet përkatëse gjenden në web-sitin e Aksionit)

○ Statuset e pjesëmarrjes në Aksionet COST

Pjesëmarrja në “Aksionet COST” mund të bëhet nën dy stative:

1. Si **Anëtar** një Grupi Pune (Working Groups) të një Aksioni
2. Si **Ekspert** i ftuar në aktivitete të veçanta në një Aksion (Takime të Grupit të Punës, pjesëmarrje në Workshop-e, etj)

○ Shkollat e trajnimit “COST”

COST ofron për kërkuesit europian edhe shkollat e trajnimit “COST”, të cilat janë platforma të fokusuar dhe shumë-disiplinore që mundësojnë shkëmbim eksperiencash me kërkuesit evropianë, lider në fushën përkatëse.

